




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT SEMAN



VENDIM

Nr.6, datë 24.02.2022

PËR

**MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES SË PËRDORIMIT TË
BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR ME NR. 222/1 PROT., DATË
21.03.2017, MIRATUAR ME VENDIM NR. 11, DATË 16.02.2017
NGA KBU SEMAN, DHËNË NË FAVOR TË SUBJEKTIT
“ANTONIO PRIFTI”**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e rinovimit të lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të ambalazhuar tregtim me enë (bot) me nr. 222/1 prot., datë 21.03.2017, miratuar me vendim nr. 11, datë 16.02.2017 nga KBU Seman, subjektit “Antonio Prifti”, me vendndodhje Njësia Administrative Bogovë Bashkia Skrapar Qarku BeratTreguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit (KRGJSH) Burimi Bogove:

- X= 514200.28; Y= 4492641.05; Z=265 m.m.n.d.

Sasia e ujit që jepet në përdorim: $Q=0.0005 \text{ m}^3/\text{s}$

2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

